

## **Për regjistrimin on-line në Sallën e Studimit të AQSh (Video nr. 1)**

Për t'u anëtarësuar on-line në Sallën e Studimit të AQSh duhen ndjekur këto hapa:

1. Hapni në browser-in tuaj adresën on-line të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave [albarchive.gov.al](http://albarchive.gov.al);
2. Klikoni meunë “Cakto vizitën në Sallën e Studimit”;
3. Klikoni opsionin “Regjistrohu”;
4. Potësoni të dhënat e kërkuara (shënim: Karta e Identiteit duhet të ngarkohet vetëm në formatin .jpg;
5. Brenda ditës së punës do të njoftoheni përmes e-mailit për emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin tuaj.

**Shënim:** në përputhje me rregulloren e Sallës së Studimit, personat që kërkojnë të dhëna pronësie apo biografike duhet të aplikojnë më parë në Postën Shqiptare dhe mund të regjistrohen në Sallën e Studimit vetëm pas një përgjigjeje të pakënaqshme nga shërbimi ynë përmes Postës.

**Për kërkimin në Query dhe porositje on-line të lëndës arkivore për studim (opsioni “Kërko me tekst të plotë”)  
(Video nr. 2)**

Në çastin e hapjes së software-it, na ofrohen katër shërbime: 1) Kërko me tekst të plotë; 2) Kërkim në pemën arkivore; 3) Fusha e kërkimit; 4) Kërkim dosjeje.

Motori i kërkimit brenda programit Query “Kërko me tekst të plotë” paraqet të gjitha rezultatet e kërkimit mbështetur tek titulli i njësive të ruajtjes (dosjeve). Për të përdorur këtë funksion, ndjekim këto hapa:

1. Hapni në browser-in tuaj adresën on-line të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave albarchive.gov.al;
2. Klikoni meunë “Katalogu Online”;
3. Përzgjidhni opsionin “Kërko me tekst të plotë”;
4. Përcaktoni një fjalë apo grup fjalësh kyçe, të cilat lidhen me kërkimin tuaj. P.sh., nëse jeni duke kërkuar të dhëna lidhur me zonën e Kuveleshit, motori i kërkimit ofron mundësinë të kërkoni duke përdorur termin gjeografik “Kurvelesh” në dritaren e kërkimit [shkruaj “Kurvelesh”].
5. Sistemi ofron, veç fjalës së kërkuar, edhe variante të tjera të fjalës, siç i përmban sistemi. Sugjerojmë që kërkuesi t’i përdorë të gjitha variantet e sugjeruara, për të pasur një kërkim gjithëpërfshirës.
6. Rezultatet e kërkimit (në rastin e shembullit, 251) paraqesin të gjithë titujt e njësive të ruajtjes (dosjeve) ku përmbahet toponimi “Kurvelesh”. Përzgjedhim një prej tyre (të dytën), dhe klikojmë.
7. Faqja pasardhëse tregon të dhënat e plota të njësisë së përzgjedhur. Nën titullin me germa bold tregohet topografia e pemës arkivore. Për të porositur një njësi ruajtjeje nga kjo pemë shkëpusim referencën arkivore. Në rastin tonë është: **Fondi 178 – Ministria e Financave, Dosja IV-2397.**
8. Për të vijuar kërkimin, kthehuni në faqen e mëparshme përmes butonit “Back” të browser-it, ose duke u kthyer në dritaren ku kemi hapur katalogun, dhe përzgjidhni një nga rezultatet e tjera të kërkimit.
9. Këtu pema arkivore paraqitet ndryshe nga e mëparshmeja. Në këtë fond dokumentet nuk janë sistemuar në rend kronologjik (si në rastin e Fondit 178 që morëm shembull pak më parë), por sipas strukturës së fondit. Për të porositur lëndën që shohim në rezultatet e kërkimit duhet të veçojmë referencën arkivore, në këtë rast: **Fondi 490 - Kryeministria, Viti 1948, Dosja 690, fletët 17, 18.**
10. Pasi keni ruajtur referencat arkivore (në formë manuale, duke i shënuar diku, apo duke hapur një dritare tjetër në browser), futuni në llogarinë individuale në faqen albarchive.gov.al përmes funksionit “Cakto vizitën në Sallën e Studimit”.
11. Përzgjidhni dhe plotësoni kërkesën duke përcaktuar: a) kategorinë e fondit; b) fondin; c) vitin; d) dosjen e kërkuar. Më pas klikoni butonin “Shto”. Kështu veproni për çdo njësi ruajtjeje, deri në 10 njësi ruajtjeje.
12. Klikoni butonin “Porosit” dhe zgjidhni një nga datat e lejuara.

13. Nëse nuk lajmëroheni përmes e-mailit apo telefonit për të ndryshuar datën apo për gabim në porositjen e lëndës arkivore, lënda e kërkuar do të jetë gati për studiuesin në Sallën e Leximit nga e hëna në të enjte në oraret 09:00 – 15:00, dhe të premte në 09:00 – 13:00.

**Për kërkimin në Query dhe porositje on-line të lëndës arkivore për studim (opsion “Kërkim në pemën arkivore”)  
(Video nr. 3)**

Për të kërkuar dhe porositur lëndë arkivore për studim duke përdorur funksionin “Kërkim në pemën arkivore” ndjekim hapat e mëposhtëm:

1. Hapni në browser-in tuaj adresën on-line të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave [albarchive.gov.al](http://albarchive.gov.al);
2. Klikoni meunë “Katalogu Online”;
1. Përzgjidhni opsionin “Kërkim në pemën arkivore”;
2. Mes kategorive përzgjidhni atë që përputhet me fondet të cilat dëshironi të studioni;
3. Hapni njësinë e ruajtjes (dosjen) në faqen ku tregohen detajet e përmbajtjes;
4. Pasi të futeni në llogarinë tuaj, plotësoni të dhënat që kërkohen, sipas kategorisë, fondit, vitit dhe dosjes;
5. Përzgjidhni dhe plotësoni kërkesën duke përcaktuar: a) kategorinë e fondit; b) fondin; c) vitin; d) dosjen e kërkuar. Më pas klikoni butonin “Shto”. Kështu veproni për çdo njësi ruajtjeje, deri në 10 njësi ruajtjeje.
6. Klikoni butonin “Porosit” dhe zgjidhni një nga datat e lejuara.
7. Nëse nuk lajmëroheni përmes e-mailit apo telefonit për të ndryshuar datën apo për gabim në porositjen e lëndës arkivore, lënda e kërkuar do të jetë gati për studiuesin në Sallën e Leximit nga e hëna në të enjte në oraret 09:00 – 15:00, dhe të premte në 09:00 – 13:00.